



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Pml.nr.54//2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar i kolegjit, Rasim Rasimi dhe Afrim Shala, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit B. N. nga Gj., për shkak të veprës penale “*Grabitja*” nga neni 329, paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë- Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.63/2022, të datës 05.09.2022 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.611/2023, të datës 24.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 06.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit B. N., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë- Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.63/2022, të datës 05.09.2022 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.611/2023, të datës 24.11.2023.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.63/2022, të datës 05.09.2022, i dënuari B. N., është shpall fajtor për shkak të veprës penale “*Grabitja*”, nga neni 329 paragrafi 1 të KPRK-së dhe për këtë veprë penale është gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej nga njëmbëdhjetë (11) vjet dhe dënim me gjobë në shumë prej 4.000 (katër mijë) € në të cilin dënim i ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim nga data 17.05.2019 e deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, dënim ky i cili do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Të dëmtuarit N. P. dhe V. P., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Është obliguar i dënuari B. N. që ti paguajë shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 600 €, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 200 € si dhe për Kompensimin e Viktimave të Krimet shumën prej 50 €.

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.611/2023, e datës 24.11.2023, i ka refuzuar si të pabazuara ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, të dëmtuarës N. P., përkitazi me kërkesën pasurore-juridike dhe për shpenzimet procedurale dhe ankesën e mbrojtësit të dënuarit B. N., ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit B. N., avokati, Vigan Rugova, për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat shkelje kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, kurse aktgjykimet e kundërshtuara t'i anulojë dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim apo të ndryshohen aktgjykimet dhe të dënuarin ta lirojë nga akuza.

Kryeprokurori i Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.28/2024, e datës 30.01.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit pasi shqyrtojë shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pasi vlerësojë pretendimet në kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

- kërkesa është e pabazuar.

Në kërkesën e mbrojtësit të dënuarit pretendohet se, gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e ka marrë duke u bazuar në prova të papranueshme-dëshminë e të bashkëpandehurit F. Gj. dhe provat e tjera si fotografitë e marra nga video incizimi i kamerave të pompës “ S.” me datë 09.06.2013, të cilat prova gjykata i ka shtrembëruar në dëm të dënuarit, pasi që nga raporti mbi ekzaminimin e konvertimit të videos të datës 27.06.2013 konstatohet se “personat e dyshimtë në ikje nuk mund të identifikohen qartë. Pretendohet se, aktgjykimet janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale duke i përsëritur gabimet e konstatuara sipas ankesës ndaj aktgjykimin të shkallës së parë.

Më tutje në kërkesë theksohet se në aktgjykimet e kundërshtuara nuk janë paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimeve si dhe nuk janë paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron të vërtetuara ose të pavërtetuara. Në aktgjykimin e shkallës së parë nuk është vërtetuar në mënyrë të veçantë saktësia e provave kundërthënëse,

arsyet e mos miratimit të propozimeve konkrete të palëve si dhe arsyet në të cilat është bazuar gjykata me rastin e zgjidhjes së çështjes juridike veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të dënuarit.

Pretendohet se edhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, për faktin se në asnjë pretendim ankimor të mbrojtjes nuk ka dhënë përgjigje për pretendime por vetëm ka konstatuar se ato pretendime janë vërtetuar dhe janë vlerësuar në mënyrë të drejtë me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Pretendohet në kërkesë se, aktgjykimet e kundërshtuara janë marrë duke shkelur dispozitën e procedurës penale nga neni 369 paragrafi 8 të KPP.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shikojë shkresat e lëndës dhe analizojë pretendimet e mbrojtësit të dënuarit B. N., konstatojë se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as me shkelje të ligjit penal, siç pretendohet në kërkesën e mbrojtësit të dënuarit.

Dispozitivi i aktgjykimeve është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe nuk është në kundërshtim me vetveten dhe me arsyetimin e këtyre aktgjykimeve, përkundrazi dispozitivi i aktgjykimin të shkallës së parë është në harmoni me pjesën e arsyetimit dhe me provat që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor. Në dispozitivin e aktgjykimin të gjykatës së shkallës së parë janë paraqitur të gjitha faktet dhe rrethanat të cilat i përbëjnë elementet e figurës së veprës penale “*grabitja*”, nga neni 329 paragrafi 1 të KPRK, për të cilën është shpallur fajtor i dënuari B. N..

Në arsyetimin e aktgjykimin të gjykatës së shkallës së parë janë paraqitur arsye të mjaftueshme dhe të qarta në lidhje me çdo pikë të aktgjykimin, duke përfshirë këtu edhe paraqitjen e arsyeve sa i përket elementeve të veprës penale për të cilën është shpall fajtor i dënuari. Gjithashtu, nga arsyetimi i aktgjykimin të gjykatës së shkallës së parë, shihet se janë vlerësuar dhe analizuar të gjitha provat një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, ku mandej pas një procesi të tillë janë nxjerrë përfundimet në lidhje me faktet vendimtare, të cilat përfundime, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës janë të drejta dhe të ligjshme.

Përkitazi me pretendimet e mbrojtësit se, aktgjykimi i kundërshtuar ka mbështetje në prova të papranueshme sepse aktgjykimi është nxjerr duke u bazuar në dëshminë e të bashkëpandehurit F. Gj., ky pretendim është i pabazuar për faktin se gjykata e shkallës së parë në këtë drejtim ka dhënë arsye të mjaftueshme, sa i përket deklaratës së bashkëpandehurit F. Gj. i cili është dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 22.11.2022, leximi i të cilës deklaratë është bërë me pëlqimin e palëve i njëjti ka qenë i gjykuar me aktgjykim të formës së prerë dhe procedura ka qenë e ndarë, nuk

është dëgjuar në cilësinë e të bashkëpandehurit por si dëshmitar, e kjo nuk paraqet provë të papranueshme siç pretendohet nga mbrojtja.

Përtej kësaj, kjo Gjykatë, konstaton se kjo deklaratë e të bashkëpandehurit nuk ka qenë e vetmja provë përmes së cilës gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar gjendjen e fakteve por kjo është vërtetuar edhe përmes provave të tjera të administruara dhe atë përveç me deklaratat e dëshmitarëve Xh. H., S. M., F. D., B. D., H. G., V. P. edhe me provat tjera materiale, ekspertizës mjeko-ligjore, video incizimi i kamerave të pompës “S.”, nga vendi i ngjarjes, përmes të cilave gjykata ka vërtetuar se ditën kritike në ora 10:18:46 në këtë video incizim vërehen dy persona, të cilët nuk janë identifikuar qartë mirëpo vërehet fizionomia e tyre dhe veshja, ashtu që në këto dy pika përputhen personat që shihen në kamerë me dëshminë e dëshmitarëve të dëgjuar në seancat e shqyrtimit gjyqësor, si dhe me dëshminë e të dëmtuarit F. P., ku dëshmitarët H. G., S. M. dhe Xh. H. kanë deklaruar se kanë qenë dy persona njëri më i gjatë e tjetri më i shkurtër, e ku edhe i dëmtuari njëjtë ka deklaruar e që përputhen në tersi me konstatimet e cekura në raportin për ekzaminim, e që për më tepër edhe i dënuari F. Gj. ka konfirmuar që në atë video personi i parë është ai, ndërsa personi tjetër pas tij është i dënuari B. N..

Gjykata e shkallës së parë, përmes provave të proceduara si më lartë drejt ka vërtetuar se ditën kritike i dënuari B. N. pasi më parë janë futur në lokalet e bastores sportive “E. Ll.”, ku po punonte i dëmtuari tani i ndjeri F. P., i dënuari B. N., pasi më parë e godet me boks të dorës të dëmtuarin, i cili nga goditja bie për tokë, ku edhe i njëjti mbetet pa vetëdije, i dënuari, ia merr shumën e të hollave në lartësi prej 2.000 € dhe së bashku me të dëmtuarin tjetër F. Gj. largohen nga vendi i ngjarjes, fakte këto dhe rrethana që janë vërtetuar edhe nga dëshmitarët e lartë të përmendur si më lartë, që do të thotë se gjykata e shkallës së parë duke vepruar konform dispozitave të nenit 369 të KPP, ka paraqitur vlerësimin e saj për të gjitha faktet vendimtare në këtë çështje penalo-juridike, i cili aspekt është arsyetuar mjaftueshëm edhe në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë (faqe 5-6).

Kështu në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të qarta për vendin, kohën, mënyrën e kryerjes së veprës penale nga i dënuari e po ashtu, edhe për mënyrën se si ka ardhur deri te kryerja e veprës penale nga i dënuari, e duke e konstatuar se përse konsideron se i dënuari e ka kryer veprën penale e jo siç pretendon mbrojtësi në kërkesë. Në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar, po ashtu, janë dhënë arsye të duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje penalo juridike duke vepruar pra konform dispozitave të nenit 369 paragrafi 6 të KPRK, ku janë paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit si ato faktike dhe juridike , të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo Gjykatë.

Prandaj duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e cekura më lartë, si dhe rrethanat dhe arsyet e cekura në aktgjykimet e kundërshtuara, rezulton se konkludimet në arsyetimin e aktgjykimeve të instancave më të ulëta gjyqësore, se i dënuari B. N.e ka kryer veprën penale të grabitjes nga neni 329 paragrafi 1 të KPRK, janë të drejta dhe në mënyrë të padyshimtë

është vërtetuar se i dënuari i ka ndërmarr të gjitha veprimet inkriminuese të cilat i përbëjnë tiparet e veprës penale për të cilën i dënuari është shpall fajtor, prandaj nuk qëndrojnë pretendimet se është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit, siç pretendon mbrojtësi i të dënuarit.

Pra, edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, është i qartë, i kuptueshëm dhe në të njëjtin janë paraqitur të gjitha arsyet për pretendimet ankimore, prandaj, si i tillë është i qëndrueshëm juridikisht dhe nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të tjera të cilat kishin me ndikuar në ligjshmërinë e vendimit të kundërshtuar me kërkesën e mbrojtësit.

Sa i përket pretendimeve të mbrojtësit të dënuarit për dënimin e shqiptuar se është shkelur dispozita e nenit 369 paragrafi 8 të KPP, sipas vlerësimit të kësaj gjykate ky pretendim është i pabazuar për faktin se gjykatat i kanë vlerësuar drejtë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat kanë ndikuar në matjen dhe shqiptimin e dënimit.

Duhet theksuar faktin se nuk është në kompetencë të Gjykatës Supreme të Kosovës shqyrtimi i lartësisë së dënimeve të shqiptuara, por e rëndësishme është se me rastin e shqiptimit të dënimit nuk janë tejkalar kompetencat ligjore dhe se në rastin konkret Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se në mënyrë të drejtë është zbatuar ligji penal dhe të dënuarit i është shqiptuar dënimi i përcaktuar në suaza të dispozitave të lartcekura për veprën penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor, kështu që pretendimet e mbrojtësit në këtë drejtim nuk qëndrojnë.

Megjithatë, bazuar në dispozitën e nenit 385, paragrafi 5. të KPP, kur është fjala për vendimin për dënim, shkelje e ligjit penal bëhet vetëm në rastet kur gjykata i ka tejkalar kompetencat ligjore me rastin e shqiptimit të dënimit, ndërsa në rastin konkret nuk ka ndodhur një gjë e tillë.

Në rast se nuk është fjala për këtë shkelje, vendimi për dënimin me këtë mjet të jashtëzakonshëm juridik, mund të kundërshtohet vetëm nëse kjo pjesë e aktgjykimit është marr me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e cila do të mund të ndërlidhej me mungesën ose paqartësitë e arsyeve lidhur me vendimin për dënimin, mirëpo, në rastin konkret një pretendim i këtillë në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është paraqitur.

Nga arsyet e cekura më lartë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është refuzuar si të pabazuar dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPPK është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.54/2024, me datë 06.02.2024

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,
Agim Maliqi